

Zef Ahmeti

MARRËDHËNIET MIDIS SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË KOMUNISTE

sipas dosjeve të diplomacisë zvicerane



Herisau 2019

PËRMBAJTJA

I. TRAKTAT-MARRËVESHJA EKONOMIKE, MONETARE MES JUGOSLLAVISË DHE SHQIPËRISË	3
II. KOLONIA E FUNDIT ZVICERANE NË SHQIPËRI DHE AMBASADA JUGOSLLAVE SI PËRFAQËSUESE INTERESAVE SHQIPTARE NË ZVICËR.....	6
III. MARRËDHËNIEN POLITIKE MES JUGOSLLAVISË DHE SHQIPËRISË.....	10
IV. NGA VËLLAZËRIA IDEOLOGJIKE NË AKUZAT RECIPROKE TË SPIUNAZHIT.....	15
V. KOMPLOTI GREKO-AMERIKAN-JUGOSLLAV KUNDËR SHQIPËRISË.....	17
VI. MARRËDHËNIET EKONOMIKE PAVARËSISHT TENSIONEVE POLITIKE	19
VII. POLEMIKA DHE PROBLEMATIKA SHQIPTARE-JUGOSLLAVE	24
<u>A NEW HIGH IN A LBANIAN-KOSOVAR RELATIONS</u>	30
BY LOUIS ZANGA	30
D'AJUSTEMENT DES PLANE ÉCONOMIQUE, D'UNION DOUANIÈRE ET D'ÉGALISATION DES MONNAIES ENTRE LA RÉPUBLIQUE FÉDÉRATIVE POPULAIRE DE YOUGOSLAVIE ET LA RÉPUBLIQUE POPULAIRE D'ALBANIE.	33
BURIMET DHE LITERATURA:	35

I. Hyrje

Tashmë gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte kontakte të ngushta ndërmjet komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë. Qysh nga ajo kohë planifikohej që pas luftës Shqipërinë t'ia bashkojnë federatës jugosllave për ta shmangur problemin me popullsinë shqiptare në Kosovë e Maqedoni.¹ Më 28 prill 1945 Jugosllavia njohu qeverinë shqiptare-komuniste. Jugosllavia dhe Shqipëria, me komunistët në pushtet, në janar të vitit 1946 miratojnë kushtetutat e tyre komuniste.² Si rezultat i kësaj "*vëllazëri ideologjike*" në vitin 1946 lidhet një traktat miqësie dhe bashkëpunimi, i cili parashikonte koordinimin e planeve ekonomike të dy vendeve, rregullimin e sistemit monetar, një bashkim doganor dhe një sistem të përbashkët çmimesh.

Me këtë traktat Shqipëria u bë një shtet satelitor jugosllav.³ Komunistët shqiptarë u konsideruan si pasues të jugosllavëve.⁴ Zvicra nuk donte të vendoste marrëdhënie diplomatike me qeverinë komuniste në Shqipëri. Nga njëra anë për shkak se kjo çështje për politikën e jashtme të Zvicrës ishte në fund të listës së prioriteteve dhe në anën tjetër sepse paraqitet shqetësim për shkak të konfliktit mes Greqisë – me të cilën Zvicra donte t'i ruante edhe më tutje "*marrëdhënie miqësore tradicionale*" - dhe Shqipërisë. Tensionet midis Bashkimit Sovjetik dhe fuqive perëndimore kishin njashtu një rëndësi të caktuar si dhe për arsye të "*kushteve të vështira*" në vetë Shqipërinë që ende nuk ishin sqaruara mjaft.⁵ Qeveria zvicerane dyshonte në legjitimitetin e qeverisë shqiptare. Kjo mosnjohje megjithatë nuk do ta pengojë Zvicrën në rast nevojë herë pas herë të trajtoj çështje ekonomike me përfaqësuesit zyrtar të Shqipërisë.⁶ Në anën tjetër Zvicra njohu qeverinë e Titos me emërimin e një ambasadori të ri zviceran, më 4.5.1945, përpara tërheqjes së Ushtrisë së Kuqe nga Jugosllavia dhe shpalljes së vendit Republikë Popullore.⁷ Në prill të vitit 1945 një mision tregtar jugosllav vizitoi Zvicrën për të blerë mallra të nevojshme për rindërtim. Megjithatë një marrëveshje tregtare dhe pagesash nuk pati deri në vitin 1946.⁸

Në janar të vitit 1948 në Moskë u diskutua çështja e Shqipërisë midis përfaqësuesve jugosllav dhe Stalinit. Stalini dha dritën e gjelbër që Jugosllavia ta "*gëlltit*" Shqipërinë, ndërsa pala jugosllave e quante "bashkim".⁹ Në rrjedhën e

¹ Holm Sundhaussen, Jugoslawien und seine Nachfolgerstaaten 1943-2011, Eine ungewöhnliche Geschichte des Gewöhnlichen, Wien, Köln, Weimar 2012, fq. 86.

² Ulf Brunnbauer, Politische Entwicklung Südosteuropas von 1945 bis 1989/91, në: Konrad Clewin, Oliver J. Schmitt (ed.), Geschichte Südosteuropas, Regensburg 2011, fq. 597-645, këtu fq. 606.

³ Holm Sundhaussen, Jugoslawien und seine Nachfolgerstaaten 1943-2011, fq. 87.

⁴ Ulf Brunnbauer, Politische Entwicklung Südosteuropas von 1945 bis 1989/91, fq. 610.

⁵ Zef Ahmeti, Der lange Weg zur Errichtung diplomatischer Beziehungen zwischen der Schweiz und Albanien, në: Albert Ramaj (Hg.), Poeta nascitur, historicus fit – Ad honorem Zef Mirdita, St. Gallen-Zagreb 2013, fq. 1169-1214, këtu fq. 1190, 1193.

⁶ Po aty fq. 1191.

⁷ Therese Steffen Gerber, Jugoslawien, in: <http://www.hls-dhs-dsfq.ch/textes/d/D3360.php> (05/05/2015).

⁸ Po aty.

⁹ Holm Sundhaussen, Jugoslawien und seine Nachfolgerstaaten 1943-2011, Eine ungewöhnliche Geschichte des Gewöhnlichen, Wien, Köln, Weimar 2012, fq. 87.

këtyre bisedimeve lidhet një marrëveshje midis Titos dhe udhëheqësit të Partisë Komuniste Shqiptare, Enver Hoxha, sipas të cilës do duhet të dërgohen dy divizione jugosllave për ta mbrojtur Shqipërinë jugore nga një sulm i mundshëm "monarko-fashistët" grekë. Për Moskën kjo ishte e patolerueshme. Ky projekt u konsiderua si një përpjekje për të mashtruar qeverinë sovjetike, ndonëse "zotëria i Kremlinit (Stalini) ishte më pak i shqetësuar për vetë çështjen por më tepër për përpjekjen e mashtrimit të atij si udhëheqës i rendit politik".¹⁰ Moska do të kishte pranuar një federatë jugosllave-shqiptare nën kontrollin sovjetik.¹¹ Për shkak të konfliktit të Kominform-it (1948)¹² mes Moskës dhe Beogradit, ku Shqipëria mbështeti anën e Bashkimit Sovjetik, si dhe për arsye të planit të udhëheqjes jugosllave në Beograd për të dërguar trupa jugosllave, çoi në një kthesë të politikës së Moskës ndaj Shqipërisë, edhe pse Beogradi ndaloi dërgimin e trupave jugosllave në Shqipëri. Moska kësaj situatë i përgjigjet në mars 1948 me dërgimin e njerëzve të besueshëm në Shqipëri. Me këtë udhëheqja pro-jugosllave u pastrua shpejt pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe krahu pro-sovjetikë mori pushtetin.¹³ Pas prishjes së marrëdhënieve me Moskën fillon përndjekja e stalinistëve në Jugosllavi¹⁴ e në anën tjetër përndjekja e "titistëve" në "demokracitë e popullore" si Shqipëria, por edhe në vende të tjera. Në vjeshtën e vitit 1949, Bashkimi Sovjetik anuloi paktin e miqësisë me Jugosllavinë dhe i kërkohet ambasadorit jugosllav të largohet nga vendi.¹⁵

Në këtë kohë të "marrëdhënieve të ftohta" është interesante të shikohet se si janë parë marrëdhëniet jugosllave-shqiptare nga diplomacia zvicerane? Zvicra, si një shtet që përdor neutralitetin si një parim udhëzues në politikën e jashtme, kishte marrë informacion interesante dhe të sakta duke i përfshirë edhe marrëdhëniet midis këtyre dy vendeve. Këtu është bërë një përpjekje për të dhënë një pasqyrë të marrëdhënieve jugosllave-shqiptare sipas dosjeve të diplomatëve zviceranë dhe si janë vlerësuar këto marrëdhënie. Natyrisht jo të gjitha dosjet janë marrë parasysh këtu sepse shumë prej tyre janë të mbyllura deri në një kohë të pacaktuar.

¹⁰ Holm Sundhaussen... fq. 87.

¹¹ Po aty., fq. 87.

¹² Ulf Brunnbauer, Politische Entwicklung Südosteuropas von 1945 bis 1989/91, fq. 628. Fjala kominform përdoret si shkurtesë për byronë informative komuniste dhe partisë së punës, një aleancë shtetesh.

¹³ Holm Sundhaussen, Jugoslawien und seine Nachfolgerstaaten 1943-2011, fq. 88.

¹⁴ Po aty, fq. 92.

¹⁵ Po aty, fq. 94.

II. Traktat-marrëveshja ekonomike, monetare mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë¹⁶

Deri në vitin 1948, kur marrëdhëniet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë zhvilloheshin në kuadër "vëllazërisë ideologjike", regjimi komunist shqiptar në Shqipëri përpiquej nëpërmjet Jugosllavisë të fitonte njohje ndërkombëtare për legjitimitetin e saj.

Në vitet e para të pasluftës nën patronazhin jugosllav¹⁷ përfaqësimi diplomatik i Zvicrës në Jugosllavi si dhe departamentet (ministrinë) përgjegjëse trajtojnë kryesisht çështjen e marrëveshjes së përgjithshme ekonomike, doganore dhe monetare midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë të nënshkruar më 27 nëntor 1946. Këtu potencohet përherë se Zvicra ende edhe më tutje nuk e njeh qeverinë komuniste në Shqipëri.

Zyrtari i ngarkuar i zyrës Zvicerane përkatësisht sekretari i Legatës në Jugosllavi i dërgon një letër dt. 4 shkurt 1947 sektorit të tregtisë në Departamentit Federal për Ekonomi (DFE)¹⁸ dhe transmeton tekstin e marrëveshjes ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë¹⁹ të miratuar nga byroja e parlamentit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë më 27 nëntor 1946. Kjo marrëveshje ishte e lidhur për 30 vite. Letrës së sekretarit të legatës, përveç marrëveshjes, i bashkëngjitet edhe një shkrim i publikuar në gazetën "Borba" të dt. 16 dhjetor 1946 i përkthyer në gjuhën frënge²⁰ ku komentohet kjo marrëveshje mes dy vendeve. Aty potencohet, se Jugosllavia angazhohet për të promovuar rindërtimin e Shqipërisë. Në këtë kontekst ishin paraparë organe koordinuese, një përafrim monetar dhe një bashkim doganor dhe se marrëveshja është "nënshkruar në një atmosferë miqësore".

Spektori i tregtisë në Departamentit Federal për Ekonomi (DFE) orienton me një letër të datës 18.02.1947²¹ Departamentin Politik Federal (vër. Ministrinë e Jashtme) (repartin për drejtësi, financa dhe çështjet e transportit), Drejtorinë Federale të Doganave dhe Bankën Kombëtare Zvicerane. Në një shënim të datës 20.2.1947 sektori i tregtisë në DFE²² drejtuar sektorit për çështje politike informon, se për këtë çështje është në kontakt me përfaqësinë diplomatike në Beograd. Në këtë kontekst shtrohet pyetja nëse ndonjë mall i Jugosllavisë mund të eksportohet nëpërmjet Shqipërisë në Zvicër kundruall një "valute të lirë". Kjo ishte e mundshme për shkak se me Shqipërinë nuk kishte marrëdhënie ekonomike obliguese dhe se qeveria e re ende nuk ishte e pranuar nga Zvicra. Ambasada ndiqte zhvillimet e eksporteve shqiptare nga Beogradi. Nëse mallrat jugosllavë arrijnë Zvicrën nëpërmjet Shqipërisë, sektori i tregtisë do të nxirrte "një detyrim pagesë të njëanshme

¹⁶ Dosja në Schweizerische Bundesarchive: Abkommen Jugoslawien-Albanien (r.C.45. You.113.4.) CH-BAR E2001E 1000-1571 3873.

¹⁷ Për më tepër krhs. Südosteuropa-Handbuch, Bd 7: Albanien, ed. von Klaus-Detlev Grothusen, Göttingen 1993, fq. 113 v.

¹⁸ Marrëveshja Jugosllavi-Shqipëri: CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 13.

¹⁹ Marrëveshja në gjuhën frënge: CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 14. Shiko shtojcën..

²⁰ Dosja e marrëveshjes Jugosllavi-Shqipëri: CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 14.

²¹ Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 16

²² Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 12.

për eksportet shqiptare". Një çështje tjetër për t'u sqaruar ishte: a duhet që marrëveshja ekonomike zvicerane-jugosllave të shtrihet sipas marrëveshjes që parashikonte bashkimin doganor jugosllav-shqiptar.

Këtu potencohet gjithashtu një aspekt politik i marrëveshjes midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë: „*Bashkimi doganor jugosllav-shqiptar ka të ngjarë të jetë rezultati i parë i përpjekjeve për të krijuar një konfederatë ballkanike nën udhëheqjen komuniste. Siç është e ditur në kuadër të kësaj federate mëtohet të krijohet një "Maqedoni e Madhe" si dhe po punohet për përfshirjen edhe të Bullgarisë*“.²³

Sektori për çështje ligjore në Departamentit Politik (DP, vër. ministrisë së jashtme zvicerane) shkruan në përgjigjen e datës 27.2.1947²⁴, se Zvicra deri më tani „*nuk e ka njohur qeverinë shqiptare*“ e kështu që duhet të shqyrtojë çështjen e efekteve në marrëdhëniet zvicerane-shqiptare të një bashkimi doganor midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Ndër të tjera, cili do jetë qëndrimi i autoriteteve zvicerane që kanë ndërmend ta mbajnë, nëse qeveria jugosllave këmbëngul në këtë bashkim doganor, që raportet tregtare me Zvicrën të vlejnjë jo vetëm për territorin e Jugosllavisë por edhe për Shqipëri. Përgjigjja ishte: „*[edhe pse] Zvicra për arsye të veçanta politike ka refuzuar të lidhë marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, nuk ka arsye të kundërshtojë krijimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve tregtare me Shqipërinë*“. Nëse qeveria jugosllave do kërkonte që marrëveshja midis Jugosllavisë dhe Zvicrës të zgjerohet edhe për territorin e Shqipërisë, Zvicra nuk do të kishte gjë kundër. „*Një procedurë e tillë mbase do të ishte edhe e përshtatshme që për shkak të vështirësive në një sektor të caktuar që dalin nga qëndrimi politik zviceran, nëse është e nevojshme, të zgjidhet në kuadër të sektorit të marrëdhënieve tregtare*“. Pasi këto çështje sqarohen brenda organeve, më 10.3.1947 Departamenti Politik (DP) i shkruan legatës zvicerane në Beograd²⁵ për njoftim edhe sektorit të tregtisë së Departamenti Federal për Ekonomi (DFE, vër.: ministria për çështje të ekonomisë) dhe sektorit politik, se Zvicra do të pajtohej me zgjerimin e marrëveshjes edhe në Shqipëri, parimisht pa pasur nevojë „*të ndryshoj qëndrimin politik përballë qeverisë së Hoxhës*“.²⁶ Për shkak se disa çështje të marrëveshjes midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë në Zvicër ende nuk ishin të qarta, përfaqësimi zviceran në Beograd merr qëndrim dhe e informon Zvicrën në çështjen, nëse marrëveshja mes këtyre dy vendeve ishte në fuqi ose jo. Në këtë shkresë potencohet: „*Siç del nga neni 5 i marrëveshjes, ajo hyri në fuqi pas nënshkrimit. Ratifikimi nuk u njoftua në Gazetën Zyrtare të Jugosllavisë, por e publikoi rregulloren nr. 150, datë 10 mars 1947, për shfuqizimin e kufijve doganorë ndërmjet dy vendeve*“.²⁷ Përveç kësaj për këtë flet edhe neni 2, paragrafi 1, për masat e parashikuara ku caktohet një normë fikse e dinarit (monedha jugosllave) 1.250.- për 100.- lekë (monedha shqiptare). Përfaqësia duke u mbështetur në burimet përgjithësisht të besueshme informon, se çështjet e importit dhe eksportit të Shqipërisë drejtohen nga Ministria e Tregtisë së Jashtme e Jugosllavisë. Diplomati në Jugosllavi informon po ashtu, se „*Shqipëria nuk ka pothuajse asnjë produkt për eksport, përveç pak duhan dhe frutave tropikale. Momentalisht eksportet mjaft të mëdha për në Shqipëri*

²³ Po aty.

²⁴ Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 11 (p.B.15.11.Alb. - SP.).

²⁵ Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 10 (r.C.45.You.113.4. - UG.).

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

(drithëra, makina rrotulluese, automjete dhe materiale ndërtimore) shpjegohen me 2 miliard dinarët e vënë në dispozicion nga parashikimet për kompensimin e planeve ekonomike të Jugosllavisë, siç doli nga konsultimet buxhetore. Po ashtu, planet e mëdha investuese, të tilla si ngritja e një impianti për furnizim me ujë dhe një qendër kontrolli elektrik për Tiranën, si dhe projektet për ndërtimin e një centrali në lumin Drin. Një pjesë e kësaj pune janë kryer nga ministritë e ndryshme të Jugosllavisë dhe pjesërisht nga "ndërmarrja importuese-eksportuese shqiptare-jugosllave" e themeluar pak më vonë në Tiranë me qendër kryesore në Beograd, Pariska ulica 13.²⁸ Ambasadori nga Beogradi raporton: „Duke pasur parasysh situatën ekonomike në Shqipëri fundja nuk mund të mohohet se interesat e Jugosllavisë në Shqipëri nuk janë vetëm të natyrës ekonomike.“²⁹ Ky interpretim flet për ndikimin politik të Jugosllavisë mbi Shqipërinë, siç u përmend më lart, me qëllim të "gëlltitjes" së vendit ose "bashkimit" të saj.

Sektorit të tregtisë së Departamenti Federal për Ekonomi (DFE) me 4 shtator 1947 i drejtohet me një shkresë Departamentit Politik ku thuhet: „Rrethanat e treguara nga njëra anë dhe takimi i shpejt i Komisionit të Përbashkët të përzier zviceran-jugosllav dhe negociatat e mëvonshme që mund të bëhen, e bëjnë megjithatë të dëshirueshme që të merret parasysh çështja e shtrirjes së zbatueshmërisë së Marrëveshjes të dt. 21 shtatorit 1946 edhe në territorin e Shqipërisë ...“³⁰ Departamenti Politik (ministra e jashtme) nga brenda (intern) bie dakord që kjo çështje të trajtohet në takimin e ardhshëm për të „mbyllur zbrazëtirën ekzistuese“.³¹ Në një përgjigje tjetër të Departamentit Politik (DP) drejtuar Sektorit të tregtisë së Departamenti Federal për Ekonomi dt. 17 shtator 1947 ministria e jashtme e Zvicrës është shumë konkrete: „Pas kontaktit me sektorin tonë të çështjeve politike ne ju informojmë, se nuk kemi asnjë kundërshtim për përfshirjen e Shqipërisë në marrëveshjen tonë ekonomike me Jugosllavinë“.³²

Pas sqarimit të kësaj çështjeje nuk do zgjatë shumë kohë deri sa të shpërthej konflikti midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Si rezultat i konfliktit politik midis Moskës dhe Beogradit, Shqipërisë Moskës i dërgoi njerëzit e vet të besueshëm në fillim të marsit 1948 për ta fituar për vete udhëheqjen politike të vendit. Me 9 korrik 1948 i dërguari zviceran në Jugosllavi i shkroi një letër konfidenciale³³ me anë të së cilës informon sektorin e tregtisë të Departamenti Federal për Ekonomi (DFE) edhe Departamentin Politik, se Shqipëria kishte anuluar të gjitha kontratat ekonomike me Jugosllavinë. Njëkohësisht me të njëjtin akt anulimi Shqipëria kërkoi që nga vendi brenda 48 orëve të largohen të gjithë specialistët jugosllavë. Përfaqësia zvicerane më tuje informon po ashtu se: „Jugosllavët janë të mendimit, se marrëveshjet bazë ekonomike janë nënshkruar për tridhjetë vjet. Anulimi është një shkelje e rëndë e rregullave themelore të së drejtës ndërkombëtare. Pretendimi që qeveria jugosllave nuk u është përmbajtur marrëveshjeve është hedhur poshtë dhe se për këtë është fajësuar sie replikë qeveria shqiptare, e cila gjithashtu ka bërë llogaritjet për atë sa ka bërë Jugosllavia deri tani për vëllain mosmirënjohës: ndihmë ekonomike nga Jugosllavia me një bilanc aktual prej 2 miliardë dinarë, për financimin e ushtrisë shqiptare me 1 ½ miliardë në vit,

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Marrëveshja Jugosllavi-Shqipëri: CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 8

³¹ Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 6, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 5.

³² Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 4.

³³ Po aty, CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 2.

duke përjashtuar atë çfarë ka deklaruar Enver Hoxha, se aleanca e përjetshme me Jugosllavinë e Marshall Titos paraqet "arritjet e lavdishme të popullit shqiptar."³⁴ Përfaqësimi zviceran gjithashtu raporton, bazuar në gazetatat, se qeveria jugosllave ka marrë njoftimin për përfundimin e marrëveshjeve, por kundërshton tezën, se këto janë tani të pavlefshme. Raportohet gjithashtu për një artikull në gazetën Borba të 6 korrikut 1948, fq.3, e cila kritikon sjelljen e Shqipërisë dhe se ka qenë Jugosllavia ajo e cila e ka forcuar Shqipërinë kundër imperializmit perëndimor dhe sa shumë ka bërë vendi (Jugosllavia) për ta mbështetur ekonomikisht Shqipërinë.³⁵

III. Kolonia e fundit zvicerane në Shqipëri dhe ambasada jugosllave si përfaqësuese interesave shqiptare në Zvicër

Konsullata zvicerane në Trieste i shkruan Departamentit Politik më 12 maj 1947 dhe pyet për koloninë e fundit ekzistuese zvicerane në Shqipëri, për të cilën deri në atë kohë ishte kujdes kjo përfaqësi, dhe si do duhej të vepronte më tutje. Bëhej fjalë për gjashtë persona: Baltischwiler Emil (e lind. 1894), Ebener Giulia (1894), Hartel Ernesto (1879) dhe fëmijët e tij Hartel Ernesto (i lind. 1903), Hartel Fernanda (e lind. 1915), Pavillard Marta Alice (1904).³⁶ Për Departamentin Politik në atë kohë e në ato rrethana një kujdes për qytetarët zviceranë që jetojnë në Shqipëri nga Triesta nuk ishte e realizueshme dhe praktikisht e pamundur. „Duke pasur parasysh rrethanat e veçanta që e lidhin Shqipërinë me Jugosllavinë, ne do ta konsideronim më të sigurt që ju të kujdeseni për bashkatdhetarët që jetojnë në Shqipëri”, i shkruan Berni ambasadës zvicerane në Jugosllavi me 10 qershor 1947.³⁷ Berni dëshironte që misioni diplomatik në Beograd t'i kontaktojë njerëzit e përmendur më lart për të verifikuar nëse ata ishin ende në Shqipëri, si dhe „nëse është e nevojshme të kërkoni nga kolonia e vogël që të caktojë një personi të besueshëm për të kryer funksione të caktuara konsullore si regjistrimi, vazhdimin e pasaportës, përcjellja e raporteve të gjendjes civile etj..³⁸ Berni donte jo vetëm që të mbajë marrëdhënie të brendshme me qytetarët e sajë në Shqipëri dhe të kryejë veprimet e nevojshme zyrtare, për më tepër ishte e dëshirueshme: „Nëse [përfaqësia zvicerane] nëpërmjet ndërmjetësimit të Ambasadës Shqiptare në Beograd ju mund të përdorni autoritetet shqiptare për mbrojtjen e këtyre zviceranëve dhe, rast pas rasti, edhe për mbrojtjen e interesave të Zvicrës.”³⁹ Berni i jep udhëzime përfaqësisë se si duhet të veproj. Së pari ajo duhet t'i drejtohet ambasadës shqiptare në Beograd me një kërkesë për të marrë pëlqimin e autoriteteve shqiptare se përfaqësia zvicerane *de facto* merr përsipër kujdesin e kolonisë zvicerane në Shqipëri dhe në këtë mënyrë t'i mbroj interesat zvicerane rast mbas rasti. Për shkak se Zvicra kishte dhënë pëlqimin për përfaqësimin *de facto* të interesave të shqiptarëve në Zvicër nga Jugosllavia,⁴⁰ Berni

³⁴ Po aty.

³⁵ Marrëveshja Jugosllavi- Shqipëri: CH-BAR E2001E 1000-1571 3873 2.

³⁶ Dosja: Vertretung albanischer Interessen durch Jugoslawien in der Schweiz (p. B. 22. 10. 1. Alb.), CH-BAR E2001E 1976-17 1082; shkresa e cekur këtu: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 35.

³⁷ E njehta dosje, letra: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 31.

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Shiko më poshtë.

nuk dyshonte, se dëshira e Zvicrës nuk do pranohej pozitivisht nga pala shqiptare. Në të njëjtën shkresë thuhet më tutje: „*Qasja jonë, madje edhe përgjigjja pozitive ndaj kërkesës për mbrojtjen e interesave shqiptare në Zvicër nga ambasada jugosllave, pa dyshim do të thotë nga ana e Zvicrës njohje e ekzistencës së shtetit shqiptar dhe, në njëfarë kuptimi, njohje de facto të qeverisë së saj. Ne e pranojmë këtë pasojë duke marrë parasysh ekzistimin e interesave të ndërsjella dhe duke pasur parasysh rrethanat e përgjithshme ekzistuese. Nga ana tjetër, për momentin nuk kemi arsye për ta njohur de jure qeverinë Hoxha ose për të ndërmarrë hapa për të vendosur marrëdhënie normale diplomatike me këtë qeveri.*“⁴¹ Meqë kjo shkresë për informim i dërgohet edhe ambasadës zvicerane në Greqi, kjo e fundit reagon me një përgjigje të dt. 18 qershor 1947⁴² drejtuar Departamentit Politik (ministrisë së jashtme zvicerane) dhe shpreh shqetësimet e saja: „...*kërkesa qeverisë shqiptare për kujdesie de facto të kolonisë zvicerane në Shqipëri nga ambasada jonë në Beograd është jo vetëm njohje aktuale e ekzistencës së shtetit shqiptar por do të thotë - jo vetëm në "njëfarë kuptimi" - por në mënyrë efektive, të paktën njohje de facto e qeverisë së saj... Do ishte e nevojshme edhe të shtrohet pyetja nëse procedura e propozuar nga ju legatës zvicerane nuk implikon një njohje de jure - një njohje e cila, pavarësisht rezervave të mia të shprehura më parë (shih letrën time të 11 korrikut 1946), do të jetë e vështirë për ta anashkaluar për një kohë të gjatë pasi Shqipëria është pranuar të jetë nënshkruese e traktatit të paqes me Italinë.*“⁴³

Lidhur me përfaqësimin e interesave shqiptare në Zvicër, ministri (ambasador) jugosllav në Bernë i shkruan shefit të Departamentin Politik, z. Max Petitpierre, më 16 maj 1947, dhe e informon atë, se qeveria e republikës popullore të Shqipërisë ka kërkuar nga qeveria e republikës popullore federale e Jugosllavisë që të marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë në Zvicër dhe se qeveria jugosllave e ka pranuar propozimin e Shqipërisë dhe se ka marrë udhëzimin ta informoj qeverinë e Zvicrës se përfaqësia e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë në Bernë tani e tutje është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë në Zvicër.⁴⁴

Departamenti Politik (DP) konfirmon se ambasadori jugosllav në Bernë ka njoftuar synimin e qeverisë jugosllave për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë në Zvicër me kërkesën e qeverisë shqiptare dhe se DP e informoi ambasadorin jugosllav më 22 maj se - pa marrë një qëndrim përfundimtar mbi këtë çështje - nuk ka asnjë kundërshtim që përfaqësia e Jugosllavisë *de facto* të kujdeset për interesat shqiptare në Zvicër.⁴⁵

Sipas udhëzimeve nga Berna, ambasada Zvicrës kontakton përfaqësuesin shqiptar në Beograd dhe ia shpreh dëshirën e Bernës. Ndërsa ministri shqiptar në

⁴¹ Po aty.

⁴² E njejtja dosje, letra: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 29.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty, Le Ministre da' Yougoslavie a la Monsieur Max Petitpierre Conseiller Fédéral Chef du Département Politique, Berne, le 16 mai 1947, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 34. "*Le Gouvernement de la République populaire d'Albanie a prié le Gouvernement de la République fédérative populaire de Yougoslavie de se charger de la protection des droits et intérêts des ressortissants albanais en Suisse.*

Le Gouvernement de la République fédérative populaire de Yougoslavie a accepté la proposition du Gouvernement de la République populaire d'Albanie et m'a ordonné de porter à la connaissance du Gouvernement Suisse que la Légation de la République fédérative populaire de Yougoslavie à Berne est chargée dorénavant de la protection des droits et intérêts des ressortissants albanais en Suisse."

⁴⁵ Po aty, EPD (p.B. 22.10.I.Alb. - XA.), konfidenciale, Bern, 12 qershor 1947, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 30.

Beograd, Tuk Jakova, ishte në Tiranë, diplomati zviceran këtë dëshirë të Bernës ja shpreh sekretarit të parë të ambasadës shqiptare, Peço Kagjini.⁴⁶ Ky i fundit premton të konsultohet me qeverinë shqiptare dhe sapo të marrë një përgjigje ai do të informojë ambasadën zvicerane.⁴⁷ Në Zvicër në të njëjtën kohë bëhen përpjekje për të konstatuar nëse personat e përmendur nga konsullata zvicerane në Trieste janë kthyer në Zvicër.⁴⁸

Në përgjigjen e Departamentit Politik (18 gusht 1947) lidhur me informatën prej ambasadës në Beogradit thuhet, se ka marrë parasysh me interes informimin e bisedimeve me Ambasadën Shqiptare në Beograd në funksion të përfaqësimit de facto të interesave të Zvicrës në Shqipëri sipas propozimit të DP-së dhe sapo të vije përgjigja e qeverisë shqiptare për kërkesën të njoftohet menjëherë Departamenti Politik (DP).⁴⁹ Sa i përket çështjes së bashkatdhetarëve që ende mund të jenë në Shqipëri, DP thekson se nga dosja e tyre nuk shihet, që sipas raportit të përfaqësisë zviceran në Beograd, të vetmet femra zvicerane që janë në pyetje, zonjusha Julia Ebener dhe zonjusha Pavillard, të jenë ende në Shqipëri apo ndërkohë të jenë kthyer në Zvicër. DP njofton më tutje se i është drejtuar qendrës federale për diasporën zvicerane që të marr informacione prej Ernst Härtel, i kthyer nga Tirana në fillim të vitit të kaluar, nëse është e mundur që ai të mund të tregoj diçka për dy zviceranet në fjalë. Dhe posa të marrim përgjigje do ju njoftojmë, thuhet më tutje në letër.⁵⁰ Me 28 gusht 1947 ministria e jashtme zvicerane (DP) e informon përfaqësinë e saj në Beograd, se ajo pas sqarimeve të bëra del se vetëm edhe për zonjushën Marta Pavillard nuk dihet nëse e ka lëshuar apo ndodhet ende në Shqipëri.⁵¹ Një muaj më vonë, 26 shtator 1947, DP i drejtohet përfaqësisë në Beograd dhe e informon për koloninë zvicerane në Shqipëri dhe Ernst Hartel, i cili deri me 1946 ka qenë në Shqipëri, i ka treguar ministrisë së jashtme, se ai nuk ka njohuri për vendndodhjen e zonjushës Pavillard. Ai atë e ka parë për herë të fundit me 1 gusht 1942 në restorantin e tij në Tiranë dhe se që nga ajo kohë nuk ka dëgjuar diçka prej saj. Ai ka shtuar, se sipas atij, nuk mund të pritet që ajo të mund të ndodhet ende në Shqipëri pasi që, nga përvoja që ka pas me rastin e arrestimit dhe depërtimin të tij nuk është e mundur që organet kompetente të vendit t'ia kenë mundësuar një zviceraneje të qëndroj edhe më tutje në Shqipëri.⁵²

Hapi dhe rekomandimet e DP drejtuar përfaqësisë në Beograd nxitën përfaqësinë zvicerane në Rumani për t'iu drejtuar DP dhe të pyes nëse vërtetë lajmi që u dha në shtypin e Bukureshtit, se trupi diplomatik është përforcuar me një ministër të ri për Shqipërinë dhe se do të ishte mirë të informohej përfaqësia

⁴⁶ Po aty, legata zvicerane në Jugosllavi drejtuar departamentit Politik, 23 korrik 1947, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 16.

⁴⁷ Po aty, letra: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 26.

⁴⁸ Po aty, letra: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 25

⁴⁹ Po aty, letra e Departamentit politik drejtuar ambasadës zvicerane në Beograd, 18 gusht 1947 , në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 24, letra e qendrës federative për diasporën zvicerane drejtuar Departamentit Politik, , 21 gusht 1947, CH-BAR E2001E 1976-17 1082 21.

⁵⁰ Po aty, CH-BAR E2001E 1976-17 1082 24.

⁵¹ Po aty, letra i dërgohet edhe përfaqësisë në Athin dhe konsullatës në Triest, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 19.

⁵² Po aty, CH-BAR E2001E 1976-17 1082 18.

zvicerane në Rumani.⁵³ Për shkak se me gjasë kontakti ndërmjet përfaqësuesit të Zvicrës dhe sekretarit të parë të përfaqësisë shqiptare në Beograd kishte shpie në keqkuptime në lidhje me atë nëse kjo ishte njohje ose jo, përfaqësia zvicerane në Rumani kishte pranuar një kopje të përgjigjes nga DP ku i përgjigjet se: „*M. Kagjini, à titre personnel, et sans vouloir rendre compte par-là de l'attitude de son Gouvernement, a exprimé l'avis qu'un échange de notes entre les deux Légations visant à expliciter, d'un commun accord, l'entente pratique des deux Légations, et partant, des deux Gouvernements, en ce qui concerne la défense des intérêts suisses en Albanie, lui paraissait superflu. Il existaient de bonnes relations entre la Légation de Suisse et la Légation d'Albanie; un usage s'était établi, point n'était besoin, à son sens, de le mieux définir. Il n'était d'ailleurs pas impossible que son Gouvernement répondît à l'aide-mémoire remis l'an dernier par M. Martin à sa Légation.*

Tout en pensant que l'envoi d'une note de rappel à la Légation d'Albanie, par laquelle nous reviendrons sur la conversation qu'avait eue M. Martin avec M. Kagjini en 1947 ainsi que sur l'aide-mémoire présenté alors, ne serait pas inopportun, je pense qu'il ne serait pas indiqué que nous marquions trop d'empressement, - si la Suisse n'a pas l'intention de reconnaître, dans un avenir plus ou moins éloigné, l'Etat albanais - à demander la confirmation, en bonne et due forme de l'usage existant. A l'appui de cette opinion, je tiens encore à rappeler que les intérêts suisses en Albanie sont absolument minimes et que toute la colonie suisse, selon toute évidence, a quitté ce pays.“⁵⁴

Përderisa ambasada zvicerane dhe Departamenti Politik (DP) fillojnë të diskutojnë me ambasadën shqiptare çështjen e përfaqësimit zviceran për Shqipëri, pa pranuar qeverinë shqiptare, marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë u përkeqësuan, kështu që në përgjigjen e DP për përfaqësinë zvicerane në Beograd thuhet, se duke pasur parasysh marrëdhëniet aktuale të tensionuara midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, do të ishte më mirë që përfaqësia zvicerane të mos merrte një qëndrim përfundimtar në këtë kohë dhe se nga ana tjetër, nuk do të kundërshtohet për dërgimin e një note kujtese përfaqësisë shqiptare për t'ia kujtuar asaj marrëdhëniet e mira që ekzistojnë midis përfaqësisë së Zvicrës dhe asaj shqiptare në Beograd dhe duke pohuar se ajo zvicerane është e autorizuar të vazhdojë t'i adresoj kësaj përfaqësie kërkesat në lidhje me mbrojtjen e interesave në Shqipëri.⁵⁵

Ngjarjet e njohura të pranverës së vitit 1948 rezultuan me një ndërprerje të papritur të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Tiranës dhe dorëheqjen e palës jugosllave nga detyra e përfaqësimit të interesave shqiptare në Zvicër. Më 3 tetor 1948 përfaqësia jugosllave informon DP, se nuk do t'i marrë më në mbrojtje

⁵³ Po aty, legata zvicerane në Rumani drejtuar Departamentit politik, 16 qershor 1948, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 15.

⁵⁴ Po aty, ministri zviceran në Jugosllavi, Zellweger, drejtuar Departamentit Politik, 14 korrik 1948 në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 13.

⁵⁵ Po aty, Departamentit Politik drejtuar legatës zvicerane në Beograd, 31 korrik 1948, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 12, krhs. po ashtu: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 11. „*Etant donné les relations actuellement tendues entre l'Albanie et la Yougoslavie, il serait en effet préférable de ne pas prendre une décision définitive en ce moment. En revanche, nous n'aurions rien à objecter contre l'envoi d'une note de rappel à la Légation d'Albanie faisant état des bonnes relations existant entre la Légation de Suisse et la Légation d'Albanie à Belgrade, et demandant à ce que vous soyez autorisé à continuer d'adresser à cette dernière Légation les demandes concernant la défenses des intérêts que nous pouvons encore avoir en Albanie.*“

interesat e Shqipërisë në Zvicër.⁵⁶ Me 13 tetor 1948 Departamenti Politik informon përfaqësinë e sajë në Beograd, se Jugosllavia me shkresën e dt. 3 tetor 1948 e ka njoftuar ministrinë e jashtme të Zvicrës (DP), se ky vend nuk do t'i përfaqësoj më tutje interesat shqiptare në Zvicër.⁵⁷

DP i kërkon ambasadës Zvicerane që ajo për momentin t'mos ia përkujtoj ambasadës shqiptare në Beograd çështjen e hapur të përfaqësimit të interesave të Zvicrës në Shqipëri dhe se ajo (ambasada zvicerane) njëherë duhet të pres. DP shprehet se kjo qasje është më e rëndësishme sesa interesat zvicerane në Shqipëri, të cilat janë shumë të vogla.⁵⁸ Dhjetë ditë më vonë në një përgjigje konfidenciale lidhur me këtë temë nga ambasada zvicerane në Beograd drejtuar ministrisë së jashtme zvicerane (DP) thuhet: „*Natyrisht pasojat fundit të kontekstit jugosllav-shqiptar nuk kanë kurrfarë ndikimi në marrëdhëniet e mira që mban përfaqësia (zvicerane) këtu me përfaqësinë shqiptare. Prandaj mund të supozohet se nuk do të pengoj asgjë në përfaqësimin de facto të mëtejshëm të interesave zvicerane në Shqipëri nga ambasada (zvicerane) në përputhje me praktikën deritanishme. Megjithatë duhet potencuar, se në këtë situatën e re një prej pikave të referimit të asaj kohe, tashmë është e pavlefshme.*“⁵⁹ Në telegramin e Bernës drejtuar ambasadës së sajë në Beograd me dt. 9.10.1948 thuhet: “*Nuk kemi ndërmend nga ne ta ngrisim çështjen e përfaqësimit të interesave shqiptare në Zvicër. Për këtë të priten hapat e Shqipërisë. Përkritazi me interesat zvicerane në Shqipëri veproni si deri me tani.*“⁶⁰ [sic]

IV. Marrëdhënien politike mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë

Për marrëdhëniet politike midis këtyre dy vendeve tashmë u potencuan disa gjëra. Fundi i patronazhit jugosllav fillon apo zëvendësohet me patronazhin e ri rus për Shqipërinë.

Siç është thënë tashmë në fokusin i këtij punimi janë marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë sipas dosjeve diplomatike zvicerane. Këto dokumente kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të këtyre marrëdhënieve midis dy vendeve, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me Zvicrën por edhe në kuadër të kontekstin gjeopolitik të skenës politike rajonale dhe asaj botërore në atë kohë.

Rreth marrëdhënieve shqiptare-jugosllave pas "kthesës" politike mes tyre raportojnë ambasadat zvicerane nga Roma, Athina dhe Beogradi. Në fillim të viteve 1950, korrespondenca midis DP dhe përfaqësimeve të saja në vendet që i cekëm u dominua nga frika, se Jugosllavia do ta sulmoj vendin, Shqipërinë. Në një letër të klasifikuar si konfidenciale (4 ½ fq.) mbi "thashethemet për Shqipërinë",

⁵⁶ Po aty, letra e përfaqësisë jugosllave drejtuar Departamentit Politik, 3 tetor 1948, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 8. “*En se référant à la lettre de Son Excellence Monsieur Milan Ristić, Ministre de Yougoslavie en Suisse, no. 345 du 16 mai 1947, et à la lettre de Son Excellence Monsieur Max Petitpierre, Conseiller fédéral, p.B. 22.10.1-Alb. Xa du 22 mai 1947. la Légation de la République Fédérative Populaire de Yougoslavie à Berne a l'honneur de porter à la connaissance du Département Politique Fédéral que, d'ordre de son Gouvernement, elle a cessé de se charger de la protection des droits et des intérêts des ressortissants albanais en Suisse.*”

⁵⁷ Departamentit Politik drejtuar legatës zvicerane në Beograd, 13 tetor 1948, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 7.

⁵⁸ Po aty, Departamentit Politik drejtuar përfaqësisë zvicerane në Beograd, 9 shtator 1948, në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 9 dhe CH-BAR E2001E 1976-17 1082 10.

⁵⁹ Po aty, letra: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 4.

⁶⁰ Po aty, telegrami në: CH-BAR E2001E 1976-17 1082 5.

përfaqësuesi zviceran në Itali i drejtohet Këshillit Federal (qeverisë) më 21 gusht 1952,⁶¹ duke informuar se në Romë jetojnë shumë emigrantë shqiptarë dhe politikisht i përkasin kampeve ose klaneve të ndryshme, të cilët ndjekin me vëmendje të madhe ngjarjet në Shqipëri, për çfarë ata vazhdimisht informohen nga njerëzit dhe lidhjet që kanë. "Kuptohet" shkruan diplomati se ata duan çlirimin e Shqipërisë nga pushteti aktual komunist. Në mesin e këtyre shqiptarëve mendohet, se ekziston një kërcënim jo i vogël për pavarësinë e Shqipërisë nga Jugosllavia e Titos, dhe pjesërisht nga Greqia, për shkak të aspiratave të saj të ripërsëritura për Epirin verior.

Në atë kohë (1952), shqiptarët në Itali gjithnjë kishin frikë se Marshalli Tito ishte duke u përgatitur për të ndërmarrë një goditje të befasishme kundër Shqipërisë. Për të kuptuar më mirë se çfarë flitej në mesin e diplomatëve, ambasada zvicerane e lartcekur informonte si vijon: „Për këtë veprim, marshalli ndjehet mjaft i fortë tani, sepse armë të rënda vijnë në Jugosllavi nga Amerika. Në kuadër të iniciativës Jugosllave, Greqia nuk do të linte pa e bërë përpjekjen për të marshuar në Shqipërinë nga jugu dhe për ta okupuar rajonin sa më thel që është e mundur në drejtim të veriut. Se okupimi i Shqipërisë do të ndodh me miratimin të heshtur të fuqive perëndimore, dhe ndoshta mund të jetë edhe si rezultat i ndonjë sugjerimi që vjen prej këtyre fuqive. Viktima do të ishin përveç shqiptarëve edhe italianët, për aq sa Italia do të përjashtohet përfundimisht nga zonat tradicionale shqiptare e interesit dhe ndikimit për të ardhmen, me disavantazh shtesë të dobësimin strategjik dhe zvogëlimit të sigurisë së saj në Adriatik.

Është interesante dhe ndoshta edhe simptomatike që në të njëjtën kohë një zë italian është shprehur në një kuptim të ngjashëm. Në revistën javore prestigjioze "Tempo" të Milanos, në numrin e 16 gushtit, u publikua një artikull me titull "I nodi al pettine mediterraneo" ku një pjesë i kushtohet çështjes shqiptare. Autori i shkrimit është Roberto Cantalupo, ish-nënsekretari i shtetit në ministrinë koloniale, më vonë si i dërguar në Egjipt, ambasador në Rio de Janeiro dhe Madrid. Ai konsiderohet si një nga eseistët më të mirë politik në Itali dhe është si një bashkëpunëtor i përhershëm për politikë të jashtme i "Tempo-s". Në artikullin e cekur Cantalupo ndër të tjera shkruan:

"Çfarë planesh ka Marshall Tito pas një periudhe të gjatë të letargjie, së fundmi në lidhje me Shqipërinë konformiste? A duhet Shtabi i Përgjithshëm italian të ngre shqetësime serioze për faktin se marshalli kroat mund të përdorë në drejtim të Shqipërisë armë moderne dhe municione që Amerika u ka vënë në dispozicion sot?

A do të duhet ndoshta ta shikojmë Jugosllavinë duke hyrë në Tiranë me justifikimin e shkëlqyer të shtypjes së ndikimit rus dhe se Greqia do e okupoj Epirin verior "nën moton e një bashkëpunimi anti-rus me Beogradin"?

Nëse një ditë ngjarjet e tilla do të ndodhin në Adriatik, aspiratat detare të Italisë në Mesdhe do të mbeten një kujtesë."

Lidhur me çështjen aq aktuale shqiptare, përfaqësia ka mund të pyes një kryetar të emigracionit serb në Romë, Vojvodën Dobroslav Jevjeviç. Ky ka dhënë këto informacione:

⁶¹Dosja Jugosllavi-Shqipëri (fq. B. 74.45), marrëdhëniet politike mes shteteve të treta, CH-BAR E2001E 1976-17 739, letra e potencuar drejtuar z. ministër Max Petitpierre, udhëheqës i Departamentit Politik: CH-BAR E2001E 1976-17 739 13.

Thashethemet rreth sulmit të planifikuar të Titos kundër Shqipërisë dhe për veprimin e njëkohshëm grek nga jugu janë të pabesueshme për arsytet e mëposhtme:

1) Bashkimi Sovjetik kurrë nuk do ta lejonte që me pushtimin e Shqipërisë t'i mbyllet e vetmja dalje e saj në Mesdhe, Tito nuk do mund të përballet me rrezikun e intervenimit kominformit, por është edhe e diskutueshme nëse Shtetet e Bashkuara do të bënin luftë për Shqipërinë.

2) Tito nuk mendon fare për ndarjen e territorit shqiptar me Greqinë. E gjithë politika ballkanike e Titos ka frymë anti-greke. Ai e pretendon të gjithë territorin shqiptar për vete, si një republikë të re në federatën jugosllave. Për më tepër, ai kurrë nuk ka hequr dorë nga plani i tij për të inkorporuar Maqedoninë greke Republikës së Maqedonisë në Jugosllavi. Greqia demokratike dhe liberale nuk përshtatet në asnjë mënyrë në planet e Titos.

3) Fuqitë perëndimore për momentin në asnjë mënyrë nuk do e mbështetnin një veprim të njëanshëm nga ana e Titos në Shqipëri, dhe pavarësisht pritjes së një kundër aksioni që mund të pasoj nga ana e Bashkimit Sovjetik, iniciativa e Titos do të nxiste një reagimin të egër të Greqisë dhe do të shkatërronte të gjithë politikën ballkanike të fuqive perëndimore në kuadër të Paktit e Atlantikut.

Sa i përket Italisë dhe interesave italiane në Adriatik, Roma duhet të jetë në një pozicionin paradoksal që detyrohet të preferojë "status quo-n" në Shqipërinë komuniste se sa ndërhyrjen në vendin e vogël. Çdo zgjerim territorial i Jugosllavisë në Adriatikon e poshtëm mundet, për arsye të dukshme, të mos jetë i pranueshëm për italianët. Sipas një thënie të vjetër diplomatike të këtushme, Shqipëria është vendi nga ku mund të shkrepet pistoleta kundër zembrës së Italisë. Për strategjinë detare italiane, humbja e ishullit të vogël të Sazanit në Gjirin e Vlorës – e cila që atëherë është shndërruar në një bazë nëndetëse ruse – ishte edhe më e dhimbshme sesa humbja e Rodonit.

Në dritën e interesave të rëndësishme italiane në anën tjetër të Adriatikut, është gjithashtu e kuptueshme që furnizimi i Jugosllavisë me materiale të rënda luftarake amerikane në Romë ka shkaktuar shqetësim. Ambasadori italian Tarchiani thuhet se është mandatuar t'ia shpreh zyrtarisht këtë shqetësim Uashingtonit. Nga ana tjetër në Itali me kënaqësi dhe lehtësim janë pranuar deklaratat e bëra nga sekretari amerikan i Shtetit Pace në shtypin e Beogradit. Siç e dini Pace tha me shumë qartësi, se ai nuk ka sjell një projekt për një pakt ushtarak midis Jugosllavisë dhe Greqisë.⁶²

Në vitet e ardhshme marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë në nivel politik do të zhvillohen në kuadër të një unioni të mundshëm që është propozuar nga jugosllavi Marshall Tito në një intervistë në New York Times të 11 nëntorit 1952. Kreu jugosllav shprehet aty, se do të mirëpriste një bashkim me Bullgarinë dhe Shqipërinë nëse këto vende donë gjithashtu të bashkohen me Jugosllavinë.

Ambasada zviceran në Greqi trajton këtë temë në letrën e 18 nëntorit 1952 drejtuar Departamentit Politik (DP).⁶³ Ajo njofton se deklarata e Titos ka shkaktuar trazim dhe shqetësim në Greqi, kështu që Greqia i ka thënë Shteteve të Bashkuara, Francës dhe Britanisë së Madhe, se "...Greqia kurrë nuk toleroi ndikimin jugosllav në Shqipëri".⁶⁴ Përveç kësaj Greqia është gjithashtu e pakënaqur me ekzistencën në Itali të grupit shqiptar për çlirimin e Shqipërisë („Comité pour la libération de

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty, Legata zvicerane drejtuar Departamentit Politik, 18 nëntor 1952, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 12.

⁶⁴ Po aty. „...que la Grèce ne tolérerait jamais influence yougoslave en Albanie.“

l'Albanie"), sepse në sytë e qeverisë greke dyshohej se Roma po bënte përgatitjet të kthejë trupat italiane në Shqipëri. Qeveria greke i frikësohej madje, si rezultat i deklaratave të bëra nga kreu jugosllav, më shumë ndikimit jugosllav në Shqipëri sesa Shqipëria në ndikimin italian („...plus encore une Albanie yougoslave, qu'une Albanie sous influence italienne”).⁶⁵ Marshalli Jugosllav merr qëndrim edhe për çështjen kontestuese të Triestes midis Italisë dhe Jugosllavisë për ndarjen e një zone “A” italiane dhe një zone “B” si jugosllave duke iu nënshtruar disa modifikimeve të vijës së demarkacionit, të cilat janë të nevojshme për arsye etnike.⁶⁶ Gazetari i New York Times, M. C. Sulzberger, i cili kishte kryer intervista me udhëheqësin jugosllav, në atë kohë ishte në Greqi dhe ambasada italiane në Athinë e kontakton atë për të konfirmuar nëse deklaratat e Titos janë të sakta. Lidhur me këtë përfaqësia zvicerane shkruan se Z. Sulzberger i ka konfirmuar të ngarkuarit me punë të Italisë, se asnjë gabim nuk ishte i mundur, sepse ai kishte shënjuar përgjigjet që i kishte dhënë Marshalli Tito gjatë intervistës së tyre. Ai madje i tregon edhe shënimet.⁶⁷ Në këtë kontekst, konfirmohet se intervista ishte publikuar saktësisht ashtu siç kishte deklaruar marshalli jugosllav.⁶⁸ Deklarimet e Titos për çështjen kontestuese të Triestës nga ana e qeverisë italiane ishin shikuar si pozitive.⁶⁹

Në fillim të vitit 1953, Departamenti Politik njoftohet prej ambasadës zvicerane në Athinë për një raport prej ambasadës italiane në Tiranë që e kishte siguruar një punëtor i legatës zvicerane. Meqë nga fundi i nëntorit 1952 autoritetet shqiptare ishin shumë më miqësore ndaj përfaqësimit italian në Tiranë, pala italiane nuk donte ta rrezikonte vënien në pikëpyetje të këtyre raporteve dhe përpiqej të shmangnin çdo incident që mund të çonte në prishje të marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Italisë.

Në letër kërkohet që burimi i raportit të mos zbulohet dhe të mos ketë informim për atë që është lexuar në këtë raport.⁷⁰ Sipas këtij raporti gjatë muajit nëntor Shqipëria do të merrte pajisje ushtarake me prejardhje sovjetike. Shqipëria ka marrë nga Bashkimi Sovjetik një sasi të madhe municioni të gjitha kalibrave, kamionë, armë këmbësorie, goma dhe karburanteve.⁷¹ Se një numër i qytetarëve sovjetikë kanë zbarkuar në Shqipëri “të cilët duket se janë teknikë të Ushtrisë së Kuqe”,⁷² se propaganda shqiptare është drejtuar kundër Jugosllavisë dhe atakon fuqishëm atë që e quan “*aleanca turko-greko-jugosllave*” dhe atë çfarë konsiderohet të

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Po aty. „...attribution de la Zone A à l'Italie et de la Zone B a la Yougoslavie, sous réserve de certaines modifications de la ligne de démarcation, qui sont nécessaires pour des raisons ethniques.”

⁶⁷ Po aty. „M. Sulzberger a affirmé au Charge d'Affaires d'Italie qu'aucune erreur n'était possible, parce qu'il avait sténographie les réponses que le Marechal Tito lui avait données, au cours de leur entretien. Il put même lui montrer ses notes.”

⁶⁸ Po aty, Departamenti Politik drejtuar z. Carl T. Stucki, ministër i Zvicrës në Greqi, 2 dhjetor 1952, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 11.

⁶⁹ Po aty, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 11.

⁷⁰ Po aty, legata zvicerane në Greqi drejtuar Departamenti Politik, Athinë, 8 janar 1953, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 10.

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty. „...qui semblent être des techniciens de l'armée rouge”

jetë si përgatitje e një agresioni kundër Shqipërisë dhe Bullgarisë.⁷³ Situata në vend është e tendosur për shkak të rivalitetit brenda komunistëve shqiptarë, përkatësisht mes Mehmet Shehut, me orientim pro jugosllav, dhe Enver Hoxhës që përfaqësonte ideologjinë e anës sovjetike. Kjo luftë për pushtet u përshkallëzua dhe se grindjet po rriteshin. Përveç kësaj, shumë anëtarë të forcave të sigurisë, të cilat ishin në rajonin e Kukësit u bashkuan me partizanët ose shkuan në Jugosllavi.⁷⁴ Por diplomatët italianë nuk besonin se pala e komunistëve pro-jugosllavë do të mund ta rrëzojnë regjimin e Enver Hoxhës. Për arsye se, sipas raportit, për sa kohë që Jugosllavia nuk ndërhyr më aktivisht në Shqipëri. Sipas të njëjtëve diplomatë italianë, Roma nuk do të tolerojë më shumë ndërhyrje në çështjet shqiptare nga Jugosllavia.⁷⁵ Në atë kohë ambasada Zvicerane shkruante, se Italia ishte në favor të sovranitetit të Shqipërisë dhe se Roma kishte mirëpritur deklaratën e Marshall Papagosit, ashtu si i është raportuar tashmë lidhur me këtë Departamenti Politik në letrën e 25 dhjetorit 1952.⁷⁶ Nga ana tjetër, italianët kishin frikë, se mos Shqipëria po bëhej jugosllave mirëpo për këtë përfaqësia zvicerane mendonte, se kjo frikë është e pa bazë pasi që rusët nuk e kanë ndërmend të largohen nga Shqipëria.⁷⁷

Këto informacione mbi situatën në Shqipëri Departamenti Politik ua transmeton me 16 janar 1953 si ambasadës zviceran në Beograd edhe asaj në Itali. Dymbëdhjetë ditë më vonë ambasada Zvicerane në Beograd këtyre çështjeve të ngritura u përgjigj me informacionet e saja.⁷⁸ Sipas këtyre informacioneve, në kuadër të vizitave shkëmbyese midis delegacioneve parlamentare dhe ushtarake të Greqisë dhe Jugosllavisë, një zëdhënës i qeverisë jugosllave ka potencuar se pavarësia dhe tërësia territoriale e Shqipërisë është në interes të vendit të tij. Eksodi i shqiptarëve të Shqipërisë që ikin (*vër. në Jugosllavi*) "*për shkak të terrorit në vendin e tyre*" vazhdon dhe se këta janë "*grupi më i madh i refugjatëve politikë* (sipas numrave zyrtar 4500, qershor 1952)". Këta, por edhe refugjatë nga vende të tjera konformiste fqinje, kanë themeluar shoqatat e tyre në Jugosllavi dhe se Beogradi inkurajon formimin e shoqatave të tilla dhe i përdor ato për qëllime të ndryshme, në veçanti për të treguar se popujt e Jugosllavisë mbajnë ndjenja miqësie ndaj popujve të këtyre vendeve, se ata nuk i ngatërrojnë me udhëheqësit e tyre të paguar nga Moska.⁷⁹ Përfaqësuesit e refugjatëve shqiptarë u takuan dy herë më 1952 dhe folën në fjalimet e tyre rreth situatës së errët dhe tragjike në Shqipëri nën sundimin e

⁷³ Po aty. „...elle attaque avec une grande violence ce qu'elle appelle «l'alliance turco-gréco-yougoslave» et ce qu'elle considère comme la préparation d'une agression contre l'Albanie et la Bulgarie.”

⁷⁴ Po aty. „Le nombre et l'importance des rencontres entre forces de sécurité et partisans augmentent de jour en jour. Ces escarmouches causent des pertes sensibles aux forces de sécurité. En outre, de nombreux membres des forces de sécurité, qui se trouvaient dans la région de Kukes, ont rejoint les partisans ou ont passé en Yougoslavie. Les partisans reçoivent une aide effective de la Yougoslavie.”

⁷⁵ Po aty. „tant que la Yougoslavie n'interviendra pas plus activement en Albanie. Selon les mêmes diplomates italiens, Rome ne tolérera pas une ingérence plus marquée de la Yougoslavie dans les affaires albanaise.”

⁷⁶ Po aty. Këtë letër nuk kam mundur ta gjejë.

⁷⁷ Po aty. „l'Italie craint que l'Albanie ne devienne Yougoslave”

⁷⁸ Legata zvicerane në Jugosllavi drejtuar Departamentit Politik, Beograd, 24 janar 1953. Në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 9.

⁷⁹ Po aty. „...Belgrade encourage la formation de telles associations et s'en sert à différentes fins, notamment pour montrer que les peuples de Yougoslavie nourrissent des sentiments d'amitié à l'égard des peuples de ces pays qu'ils ne confondent pas avec leurs dirigeants actuels à la solde de Moscou.”

Enver Hoxhës, i cili vendin e tij e bëri burg. Ata dhanë shumë lëvdata qeverisë jugosllave për mikpritjen e tyre, por nga ana tjetër ndër ta nganjëherë infiltrohen agjentë të shërbimit të sigurimit shqiptar, si anë tjetër e monedhës.⁸⁰ Sipas informacionit jugosllav, Ministria e Brendshme e Shqipërisë ka urdhëruar kohëve të fundit arrestimin e të gjithë qytetarëve që nuk pajtohen me republikën demokratike popullore. Kjo valë e arrestimeve thuhet të ketë ndodhur, në veçanti, në rajonin fqinj kufitar me Jugosllavinë.⁸¹ Këto informacione nga Beogradi ia përcjellë Departamenti Politik më tutje ambasadave zvicerane në Itali dhe Greqi.⁸²

Pasi ambasada zvicerane në Beograd pranon një raport (3 nëntor 1953) mbi marrëdhëniet e Bullgarisë me vendet fqinje, ajo në fund të vitit 1953 gjithashtu jep informacione mbi marrëdhëniet e Jugosllavisë me vendet fqinje. Sipas raportit, Jugosllavia vazhdon normalizimin e marrëdhënieve me vendet e Bllokut Lindor. Sa i përket Shqipërisë jepet informacioni, se raportet e këqija mbeten vetëm me Shqipërinë mandej eskalon konflikti në një përpjekje për zgjidhjen shumë incidente kufitare me anë të negocimit për një marrëveshje që do dilte nga një komision dypalësh, ngjashëm si me Hungarinë, Bullgarinë dhe Rumaninë. Por duket se pala shqiptare ka paraqitur propozime të reja që duhet të kenë burimin prej Moskës.⁸³

V. Nga vëllazëria ideologjike në akuzat reciproke të spiunazhit

Marrëdhëniet midis vendeve komuniste Jugosllavisë dhe Shqipërisë rëndohen ndër të tjera gjithashtu edhe me ngritjen e akuzave të ndërsjella për veprime spiunazhi. Ambasadori Ziegler në Beograd informon Departamentin Politik me anë të një telegrami (17.2.1959), se pala jugosllave i ka drejtuar qeverisë shqiptare një notë proteste me një gjuhë mjaft të ashpër („*en termes très énergiques*“) për veprimet e spiunazhit kundër Jugosllavisë („*concernant activité espionnage contre Yougoslavie*“).⁸⁴ Në këtë notë jugosllave flitet për sabotimin kundër Marshall Tito dhe Jugosllavisë dhe se këto veprime do të rrezikojnë paqen në këtë pjesë të Evropës. Në këtë njoftim potencohet po ashtu se përfaqësuesi shqiptar në Beograd z. Rako Naco ka refuzuar pranimin e notës nga qeveria Jugosllave.⁸⁵

Më 15 gusht 1959 ambasadori zviceran në Beograd informon, se është kthyer në detyrë ministri i republikës popullore të Shqipërisë, Pirro Koçi, i cili vitin e kaluar ishte larguar për shkak të konfliktit jugosllav-shqiptar. Kjo u bë e mundur sepse në rrethana tjera

⁸⁰ Po aty. „...Parmi eux, cependant, se glissent parfois quelque agent des services de sécurité albanais: c'est l'envers de la médaille.“

⁸¹ Po aty.

⁸² Departamentit Politik drejtuar z. Enrico Celio, ministër i Zvicrës në Itali, konfidenciale, 3 shkurt 1953, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 8; Departamentit Politik drejtuar z. Cari T. Stucki, ministër i Zvicrës në Greqi, konfidenciale, 3 shkurt 1953, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 7.

⁸³ Letër politike, 24 nëntor 1953, legata zvicerane në Jugosllavi drejtuar Departamentit Politik, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 6. „Ce n'est qu'avec l'Albanie que les Rapports restent mauvais. Une tentative de régler les nombreux incidents de frontière par la négociation d'un accord instituant une commission bipartite, come avec Hongrie, la Bulgarie et la Roumanie, a sombre dans des injuref. Mais il semble que les Albanais viennent de présenter de nouvelles propositionf. Ils auront été chapitres par Moscou.“

⁸⁴ Telegram nr. 10, Beograd, 17.2.1959 20h00, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 5.

⁸⁵ Po aty. „La charge d'affaires albanaise à Belgrade, m. Rako Naco, a refusé d'accepter cette note du gouvernement de la Yougoslavie.“

ata që merren me këto raporte do t'i kishte frymëzuar për tituj e komente se ky është një çelës për marrëdhëniet midis Moskës dhe Beogradit duke zbuluar vetë qëllimet e Kremlinit.⁸⁶ Sepse që nga gushti 1959 tensionet amerikano-sovjetike kishin ndikim në të gjithë situatën ndërkombëtare dhe se marrëdhëniet e Jugosllavisë me fqinjtë e saj të vogël shqiptar ishin të deformuara.⁸⁷ Marrëdhëniet mes këtyre dy vendeve mbesin edhe më tutje të tensionuara. Po ashtu edhe në vitin 1960 diplomacia zvicerane në Beograd informon, se të ngarkuarit me punë në ambasada e të dy vendeve nuk kanë pothuajse fare kontakt me ministritë e jashtme të vendeve përkatëse.⁸⁸ Për të njoftuar më tepër për këto marrëdhënie të tensionuara ambasada zvicerane në Beograd përkthen edhe një artikull nga serbishtja në frëngjisht që ishte publikuar në gazeta e Beogradit, *Borba*, e dt. 16 tetor 1960, ku shkruhet se si janë trajtuan diplomatët jugosllavë nga pala shqiptare.⁸⁹ Në artikullin me autorë R. Balajski thuhet, se kushtet në të cilat punojnë dhe jetojnë zyrtarët e Ambasadës Jugosllave në Tiranë janë shumë të pafavorshme për shkak të sjelljes së autoriteteve shqiptare ndaj ambasadës së Beogradit në Tiranë. Përkundër protestave të shumta situata e personelit të ambasadës jugosllave në Tiranë nuk është përmirësuar. Gazetari përmend rastet që ai i quan si "të paprecedent". Me tutje thuhet se diplomatët jugosllavë tashmë në kufi duhet t'iu nënshtrohen një procedure të komplikuar. Ata janë duke u kontrolluar në imtësi e me kujdes dhe se kjo sjellje është bërë një obsesion i autoriteteve kufitare shqiptare. Taktikat vonuese në lëshimin e vizave ose shoqërimi i diplomatëve nga një eskortë policore deri në Tiranë. Në Tiranë, çdo diplomat jugosllav shoqërohet nga 2-3 persona kudo dhe në çdo hap. Por edhe, se kushtet e punës në ndërtesën përfaqësuese nuk janë adekuate, energjia elektrike ndërpritet, materialet e ndërtimit nuk sigurohen ose, siç ishte rasti në mars 1959, kur përfaqësia jugosllave donte të sillte material rindërtimi nga Jugosllavia për riparimet në rezidencën Jugosllave, materiali u ndalua në kufi. Qasja në trajtimin mjekësor për diplomatët jugosllavë dhe familjet e tyre vështirësohet dhe i nënshtrohet një kontrolli të ashpër. Kjo qasje e vështirë në trajtimin mjekësor në artikull u kritikua si "mungesë e ndjenjës humanitare". Se në maj të vitit 1960 përkthyesi shqiptar ka dhënë dorëheqjen nga ambasada jugosllave, gjë që shkaktoi vështirësi të konsiderueshme në kryerjen e punëve të ambasadës. Kur u pyet autoriteti shqiptar se ku ishte përkthyesi ata përgjigjen, se ai ishte i sëmurë dhe nuk do të kthehet më. Si dhe fakti që të afërmeve jugosllav në Shqipëri nuk u lejohet t'i shfrytëzojnë shërbimet e përfaqësuesit të Jugosllavisë. Pengesat me të cilat ndeshet përfaqësia e Jugosllavisë të shkaktuara nga autoritetet shqiptare nuk janë vetëm shkelje e detyrimeve kontraktuale që i pengojnë ata të punojnë dhe jetojnë atje, porse ata atje persekutohen dhe torturohen psikologjikisht. Kjo gjendje po zgjat që prej dhjetë vite. Më 2 mars 1961 qeveria jugosllave njofton se "si pasojë e qëndrimit vazhdimisht armiqësor të autoriteteve shqiptare, ata personelin e ambasadës së tyre në Tiranë e kanë reduktuar në

⁸⁶ Legata zvicerane drejtuar Departamentit Politik, 15 gusht 1959, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 4. „En d'autres circonstances, ce retour eût défrayé la chronique et inspiré les commentaires de ceux qui suivent à la loupe l'état des relations alban-yougoslaves comme étant un indice des rapports entre Moscou et Belgrade, eux-mêmes révélateurs des intentions du Kremlin.“

⁸⁷ Po aty. „que les relations de la Yougoslavie avec son petit voisin albanais en sont devenues crépusculaires.“

⁸⁸ Legata e zvicres në Jugosllavi drejtuar z. ministrit Robert KOHLI, sekretar gjeneral i Departamentit Politik, Beograd, 31 tetor 1960, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 3. „Les Chargés d'affaires de l'un et de l'autre pays n'ont presque aucun contact avec le Ministère des Affaires étrangères de leur pays de résidence.“

⁸⁹ Po aty.

minimum".⁹⁰ Sipas palës jugosllave nuk mund të pritet prej stafit të Jugosllavisë në kryeqytetin shqiptar të përballoj diskriminimin, trajtimin e keq dhe fyerjeve përballë të cilave ajo u është ekspozuar.⁹¹ Në atë kohë, qeveria e Beogradit konkludonte në mënyrë specifike se më 22 shkurt 1961, një punonjës i ambasadës jugosllave u rrah nga policia shqiptare pa asnjë arsye sa bënte pazar në treg. Diplomati zviceran më tej informon: "përfaqësuesi jugosllav në Tiranë, Vujiçiç, më 4 mars u kthye në Beograd me një pjesë të personelit dhe tani kjo do të thotë për diplomatët e këtushëm shqiptarë se ata duhet të kthehen në atdheun e tyre deri në një të vetmin".⁹² Nga ana tjetër, më 2 dhe 3 mars 1961 u zhvillua një proces i madh gjyqësor para gjykatës së rrethit në Prizren për spiunazh, me ç' rast "te dy të akuzuarit shqiptarë pranuan të jenë porositur nga shërbimi sekret (Sigurimi) për propagandë irredentiste brenda rajonit autonom të Kosovës dhe Metohisë me qëllim të rikthimit të kësaj zone nën sovranitetin territorial të Shqipërisë. Edhe këtu, qeveria jugosllave ka shkruar një notë diplomatike, e cila, megjithatë, është refuzuar nga autoritetet shqiptare."⁹³

Për akuzat e palës jugosllave diplomati zviceran shkruan, se ambasadori austriak në Beograd, i akredituar nga qeveria e tij edhe për Shqipëri, i cili sapo ka bërë udhëtimin e tij të parë në Tiranë më ka siguruar se jeta e disa kolegëve perëndimorë që janë në lëvizje (italian, francez, turk) nuk është shumë më e këndshme se ajo që paraqitet në artikullin e bashkangjitur.⁹⁴

VI. Komploti greko-amerikan-jugosllav kundër Shqipërisë

Në vitet 1960 propaganda u përhap edhe në Tiranë se kishte një "komplot greko-amerikan-jugosllav" kundër Shqipërisë. Për këtë propagandë ambasadori zviceran në atë kohë shkroi: "Si e tillë njëherit mund të konsiderohet si një gjë absurde e ripërsëritur, sipas të cilës Greqia dhe Jugosllavia së bashku me flotën e 6-të amerikane po përgatisin një sulm ndaj Shqipërisë, e cila ka për qëllim ndarjen e Republikës Popullore".⁹⁵ Ambasadori zviceran në Beograd informon Departamentin Politik në detaje rreth kërcënimit të përhapur, përkatësisht komplotit në fjalë. Në një „lettre politique“ të përfaqësuesi zviceran në fund të nëntorit 1961 informohet rreth ndërhyrjes së mundshme të Jugosllavisë në Shqipëri u konsiderua si vlerësim "përtej cakut" – si i pamundshëm dhe, shikuar prej këndvështrimit të Beogradit, "duhet të quhet edhe si e veçantë duke marrë parasysh se këto thashetheme të tilla përhapen nga postet që duhet të merren seriozisht", shkruan diplomati, sepse si në Beograd ashtu edhe Moskë e dinë se çdo përpjekje për të bërë një rregullim kufitar ose shkelje të integritetit shtetëror apo territorial në Evropë mund të shpije në komplikime të paparashikuara.⁹⁶ Për më tepër, jo vetëm Italia, por edhe Greqia do të reagonin shumë

⁹⁰ Shkresë politike. Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sekretarit gjeneral në Departamentin Politik, 7 mars 1961, në: E 2001(E)1976/17/ 258.

⁹¹ Po aty.

⁹² Po aty.

⁹³ Po aty.

⁹⁴ Ambasadori zviceran në Beograd, Ganz, drejtuar z. ambasadorit Pierre Mioheli, sekretar gjeneral i Departamentit Politik, Beograd, 27 nëntor 1961, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 2. „L'Ambassadeur d'Autriche à Belgrade, également accrédité par son Gouvernement en Albanie, vient de faire son premier voyage à Tirana et m'a assuré que la vie des quelques collègues occidentaux surplace (Italie, France, Turquie) n'est pas beaucoup plus agréable que ce qui ressort de l'article annexé.“

⁹⁵ Po aty. E 2001(E)1976/17/ 258.

⁹⁶ Po aty. E2001E 1976-17 739 2.

keq për plane të tilla, se për shkak se ajo mban një "nostalgie profunde" për ish koloninë saj të mëparshme, kjo për shkak të interesit të saj të shquar për Epirin verior shqiptar (me Gjirokastrën dhe Butrintin) dhe të tensioneve të përhershme me Maqedoninë dhe maqedonasit.⁹⁷ Kundër kësaj flet edhe fakti se sekretari i shtetit jugosllav për punët e jashtme, i cili tash së fundmi i ka nënvizuar ambasadorit grek politikën e tij strikte "hands off" ndaj Shqipërisë, pasi nga Tirana edhe një herë u trumbetua për rrezikun e një komploti greko-amerikan-jugosllav kundër integritetit territorial shqiptar.⁹⁸

Nga ana tjetër roli i jugosllavëve në "nxitjen e një revolucioni brenda Shqipërisë" nuk mund të mohohet. Diplomati zviceran thotë se atij i ka siguruar kolegu polak që ka qenë në detyrë në Athinë prej 1956 deri me 1959 dhe prej 1959 me detyrë në Beograd, se komunistët jugosllavë, pavarësisht nga spastrimet mizore dhe përndjekjet e Enver Hoxhës dhe të tjerëve, ende kanë simpatizantë të shumtë e të efektshëm në Shqipëri që presin me durim për momentin e tyre dhe se vazhdojnë ta informojnë përherë – (Jugosllavinë, sic)-për zhoillimet.⁹⁹ Departamenti Politik informohet për popullatën e Republikës Popullore të Shqipërisë (1.5 milionë) si dhe për "zonën fqinje Kosmet-in (Kosovën e Metohinë)", se ka një popullsi prej 800,000 banorësh kryesisht shqiptarë e myslimanë. Për shkak se kufiri i gjatë 500 km është pothuajse i pakontrollueshëm „spiunohet pa ndërprerë“. Përveç kësaj, një numër i madh, pjesërisht "refugjatë të shquar, nga perandoria e Enver Hoxhës, janë aktiv në Kosmet". Diplomati zviceran beson, se është brenda kufijve të mundësisë, që komunistët jugosllavë, në marrëveshje me ose të paktën jo kundër Moskës, do të bëjnë të rrëzojnë diktaturën e Hoxhës.¹⁰⁰

Lidhur me thashethemet se Italia dhe Turqia po e përdorin thyerjen e Shqipërisë me Bllokun Lindor për të rritur ndikimin e tyre nuk është e vërtetë, thotë diplomati zviceran, sepse të dy kolegët e tij italianë dhe turq i konsiderojnë këto thashetheme të shpikur nga ajri, dhe se personeli diplomatik i të dy vendeve në Tiranë mbetet i kufizuar në një minimum të rreptë. Kështu pra supozimi mbetet i justifikuar, thotë diplomati, se Shqipëria për momentin do të mbetet e izoluar dhe me ndihmën e Kinës do të përpiqet të çlirohet nga gjendja e vështirë ekonomike.¹⁰¹

Në Beograd kishte ende një shqetësim për zhvillimet e ardhshme në Tiranë. Ky shqetësim u justifikua nga fakti i "përprjekjeve të Greqisë për të përfituar më së shumti nga kjo situatë, në një moment kur marrëdhëniet greke-jugosllave janë tendosur përsëri për shkak të çështjes maqedone".¹⁰²

Që kur regjimi komunist në Shqipëri përhëndetet prej patronazhit rus, ai i drejtohet atij kinez. Diplomati zviceran informon Departamentin Politik për protokollat e nënshkruara midis Kinës dhe Shqipërisë më 13 janar 1962: Marrëveshje për dhënien e një kredie kineze Shqipërisë; për furnizimin me pajisje kineze dhe asistencë teknike për Shqipërinë; për përdorimin e kredisë kineze në vitin 1962; protokollin e komisionit për bashkëpunim shkencor dhe teknik dhe protokollin për mallrat dhe pagesat për vitin 1962.¹⁰³ Megjithatë, marrëveshja më e

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Po aty.

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Ambasadori zviceran në Beograd, Ganz, drejtuar z. Pierre Mioheli, sekretar gjeneral i Departamentit Politik, letër politike, Beograd, 24 janar 1962, në: CH-BAR E2001E 1976-17 739 1.

¹⁰³ Po aty.

rëndësishme thuhet se është lidhur në fund të dhjetorit 1961 lidhur me themelimin e një kompanie të anijeve kinezo-shqiptare (lexo: kineze).¹⁰⁴

Hendeku i krijuar nga largimi i pranisë ruse në Shqipëri ka lënë probleme edhe për ekonominë shqiptare, tha diplomati: „*Vihet re se pothuajse e gjithë industria në Shqipëri është ndërtuar dhe vendosur nga rusët. Mirëmbajtja dhe furnizimi i pjesëve ishin plotësisht në duart e tyre. Tërheqja totale e personelit rus dhe ndërprerja e të gjitha dërgesave nuk mund të kompensoheshin nga ndihma kineze. Vetëm për këtë arsye Shqipëria është e detyruar të kërkojë një lidhje në Perëndim.*

Më 20 janar u njoftua se në Varshavë u nënshkrua një protokoll për shkëmbimin e mallrave Poloni-Shqipëri për vitin 1962. Sipas kësaj Tirana furnizon polakët në rend të parë me krom, asfalt, bakër dhe pambuk dhe merr pajisjet teknike, koks, metale të mbështjella, tekstile etj. Polakët do t'i vazhdojnë marrëdhëniet kontraktuale tregtare tashmë të vendosura edhe në vitin e ardhshëm.

Si më konfirmon kolegu im austriak, qeveria e tij miratoi hapjen e Ambasadës Shqiptare në Vjenë, por nuk ka ndërmend të bëjë të njëjtën gjë edhe në Tiranë. Ambasadori Geertz do të vazhdojë të përfaqësojë vendin e tij në Shqipëri nga Beogradi. Pas një ndërprerje prej dy vitesh ai ka në plan të shkojë përsëri në Tiranë në mars të këtij viti për të rivendosë kontakte. Momentalisht atashëu ushtarak francez në Beograd, kolonel Baudet, është atje.

Polemikat e ashpra midis Tiranës dhe Beogradit vazhdojnë dhe nuk ka indikacione se dy shtetet komuniste të shkëputura nga Moska në të ardhmen e afërt do mund të afrohen më shumë.“¹⁰⁵

VII. Marrëdhëniet ekonomike pavarësisht tensioneve politike

Në një artikull të shkurtër më 19 maj 1955 gazeta ruse Pravda njofton për nënshkrimin e një marrëveshjeje tregtare midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ky njoftim bazohej në gazetën e Beogradit Borba. Këtu informohej se kontrata është nënshkruar në Beograd për shkëmbimin e mallrave me vlerë 1.5 milionë dollarë për periudhën deri më 31 dhjetor 1955. Këtë informacion i përcolli sektorit të tregtisë së Zvicrës ambasada e zvicerane në Rusi.¹⁰⁶ Ky informim u konfirmua nga përfaqësia zvicerane në Beograd se Shqipëria si vendi i fundit i kominformit që kishte ngritur bllokadën kundër Jugosllavisë në vitin 1948, gjithashtu lidhi një marrëveshje tregtare me Jugosllavinë dhe kjo kontratë u nënshkrua më 17 maj 1955. Diplomati konsideroi se shkëmbimi i mallrave midis këtyre dy vendeve për Zvicrën ishte i një rëndësie të vogël.¹⁰⁷

Dy vjet më vonë, pas pesë ditë negociatash midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, më 12 janar 1957, u nënshkrua një marrëveshje tjetër tregtare prej 2 milionë dollarësh për vitin 1957. Për këtë informacion, i cili gjithashtu listonte edhe produktet, ambasada zvicerane informohet nga shtypi dhe pastaj këtë informatë e dërgon në Zvicër në adresën e duhur.¹⁰⁸

¹⁰⁴ Po aty.

¹⁰⁵ Po aty.

¹⁰⁶ Legata e Zvicrës në Rusi drejtuar divizionit për tregti në departamentin federal të ekonomisë, Moskë, 20 maj 1955, kopja i dërgohet Departamentit Politik, në : CH-BAR E2001E 1970-217 7654 3.

¹⁰⁷ Legata zvicerane në Jugosllavi drejtuar sektorit të tregtisë në Departamentin e Ekonomisë, 25. maj 1955, një kopje Departamentit Politik, në: CH-BAR E2001E 1970-217 7654 2.

¹⁰⁸ Legata e Zvicrës në Jugosllavi drejtuar divizionit për tregti në departamentin federal të ekonomisë, 16 janar 1957, një kopje Departamentit Politik, në: CH-BAR E2001E 1970-217 7654 1.

Marrëveshja tjetër do të nënshkruhet më 21 tetor 1968 në Beograd për shkëmbimin e mallrave për vitin 1969. Sipas një raporti nga agjencia jugosllave "Tanjug", shkëmbimi i mallrave me Shqipërinë për vitin 1969 pritet të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme. Diplomati i ngarkuar i Shqipërisë i konfirmon këtë informacion diplomatit zviceran, në një rast takimi që "ndodhin herë pas here në raste pritjeje".¹⁰⁹ Përveç kësaj njofton më tej diplomati se ai ka mësuar nga pala kompetente jugosllave, se „negociatat me Shqipërinë, të cilat zhvillohen çdo vit, nuk kanë qenë për një kohë të gjatë aq të këndshme dhe të shpejta si kësaj radhe. Jugosllavët me sa duket shpresojnë të zhvillojnë marrëdhënie më normale me Shqipërinë jo vetëm ekonomikisht por edhe në fusha të tjera.

Sidoqoftë mbetet për t'u parë nëse këto pritshmëri do të përmbushen apo jo, ndonëse disa javë kanë ndalur sulmet ideologjike të Tiranës kundër Jugosllavisë dhe Titos pasi rusët pushtuan Çekoslovakinë. Megjithatë, që nga fillimi i nëntorit, kemi një përmytje të sulmeve urretjese që po derdhet përsëri nga udhëheqësit shqiptarë kundër Jugosllavisë fqinje dhe trazirat e fundit në provincën e "Kosovës dhe Metohisë", e cila është e banuar kryesisht nga shqiptarët, nuk duket se do të çojë në marrëdhënie më të mira. Megjithëse Shqipëria do të kishte çdo interes në rritjen e tregtisë me Jugosllavinë, një zhvillim i tillë duket të jetë i pamundur përderisa nuk ka ndryshim radikal të regjimit në Tiranë dhe propaganda e saj nuk është asgjë tjetër veçse një zëdhënëse e komunistëve."¹¹⁰

Dy vjet më vonë, më 20 maj 1971, nënshkruhet një marrëveshje tjetër tregtare më e gjatë në kohë midis këtyre dy vendeve për vitet 1971-1975. Marrëveshja e re tregtare gjatë pesë viteve të ardhshme parashihte një rritje të konsiderueshme të tregtisë midis dy vendeve. Pritej që tregtia duhet të arrijë shumën prej 110 milionë dollarësh, njofton përfaqësia zvicerane.¹¹¹

Për herë të parë mbas një dekade, një zëvendësministër i tregtisë i Shqipërisë viziton Beogradin në mes të dhjetorit 1971 për të negociuar protokollin e zakonshëm vjetor mbi tregtinë në vitin 1972. Në anën jugosllave ai që udhëhoqi bisedimet ishte sekretari i tregtisë së jashtme, Teodosije Glisliq. Ambasadori zviceran jep vlerësimin e tij, se si burimet jugosllave edhe ato shqiptare njoftojnë njëzëri që për vitin 1972 pritet një rritje e konsiderueshme e tregtisë, gjë që duket se konfirmon referimin e komunikatës për rritje e tregtisë në 20 milionë US dollarë. Kreu i delegacionit shqiptar gjatë negociatave u prit nga sekretari i tregtisë së jashtme jugosllave, M. Haxhiç.¹¹² Megjithë qëllimit të parashikuar dhe të planifikuar, siç raportoi shtypi jugosllav duke u mbështetur në deklaratat e Dhomës Jugosllave të Tregtisë, eksportet jugosllave në Shqipëri këtë vit nuk ishin aq të larta sa pritej. Megjithëse eksportet u rritën me 67.8% në nëntë muajt e parë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo rritje ishte nën objektivin e synuar. Shumë më pak të kënaqshme ishin hyrjet nga Shqipëria që kishin një rritje

¹⁰⁹ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 3 dhjetor 1968, në: CH-BAR E7110 1979-14 337 1.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 24 maj 1971, në: CH-BAR E7110 1982-108 332 1.

¹¹² Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 5 janar 1972, në: CH-BAR E7110 1983-13 332 2.

vetëm prej 8,6 %.¹¹³ „Nga kjo rezultoi një mospërputhje ndërmjet importeve dhe eksporteve, të cilat, siç thekson dhoma jugosllave, ishte e dëmshme për zhvillimin normal të tregtisë ndërmjet dy vendeve. Prandaj dhoma ekonomike konkludoi se duhet të bëhen përpjekje për të nxitur importet shqiptare në mënyrë që të arrihet rritja e xhiros së parashikuar nga Protokollin i vitit 1972 për shkëmbimin e mallrave.“¹¹⁴ Pas përfundimit të kësaj periudhe 5-vjeçare, ambasadori zviceran, i mbështetur në shtypin jugosllav, raporton se midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë pak më herët në Beograd është nënshkruar një protokoll tregtar për vitin 1976. Kjo marrëveshje parashikoi një vëllim tregtar prej 40 milionë dollarësh, 10% më shumë se në vitin 1975, që reflekton dëshirën e të dyja palëve për të intensifikuar marrëdhëniet e tyre tregtare.¹¹⁵

Kjo natyrë periodike e marrëveshjeve tregtare ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë. Kështu ndodhi edhe me rastin e vizitës së zëvendësministrit të tregtisë së Shqipërisë, Marko Zega, në Beograd, ku më 17 qershor 1976 u nënshkrua marrëveshja e ardhshme tregtare për dy vitet e vijuese, 1976-1978. Me këtë rast u tha, se tregtia mes dy vendeve në përgjithësi ishte në rrugën e duhur duke ofruar mundësi e një zhvillimi të qëndrueshëm të marrëdhënieve ekonomike. Një vështrim i përgjithshëm i shefit të delegacionit shqiptar dhe sekretarit federativ për tregtinë e jashtme jugosllave, Emile Ludviger, mundëson marrjen në konsideratë perspektivat e ardhshme për tregtinë shqiptare-jugosllave.¹¹⁶

Për të kuptuar më mirë këto marrëdhënie mes këtyre dy vendeve, është e rëndësishme të plotësohet njohja me zhvillimet e patronazheve të Shqipërisë deri në fazën e vetë-izolimit dhe ngjarjeve në Jugosllavi edhe në raport me Kosovën. Kjo vlen për lexuesin. Le të vazhdojmë me marrëveshjet e ndryshme midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Ambasadori zviceran në Beograd njofton se ishte nënshkruar një marrëveshje për ndërtimin e lidhjes së parë hekurudhore midis këtyre dy vendeve. Diplomati shkruan: „Megjithëse ka ende kohë deri në hapjen e kësaj linje, Shqipëria me nënshkrimin e kësaj marrëveshje ka bërë një tjetër hap të rëndësishëm i cili do duhej ta nxirrte vendin ngadalë jashtë izolimit të tanishëm. Lidhja e planifikuar Laç - Shkodër - Bar -Titograd do t'i lidhë jo vetëm kryeqytetin Tiranën dhe qendrat e rëndësishme si Durrësin, Elbasani dhe Ballshin me Jugosllavinë por me gjithë rrjetin hekurudhor evropian.“¹¹⁷ Në kuadër të këtij bashkëpunimi ekonomik, sekretari federal për tregti të jashtme i Jugosllave, Metod Rotar, vizitoi Shqipërinë nga 12-

¹¹³ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 21 nëntor 1972, në: CH-BAR E7110 1983-13 332 1.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 7 prill 1976, në : CH-BAR E7110 1987-20 333 2.

¹¹⁶ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 24 qershor 1976, në: CH-BAR E7110 1987-20 333 1. „Il a été constaté que les échanges commerciaux entre les deux pays suivait dans l'ensemble, une voie déjà tracée mais offrant la possibilité d'un développement stable des relations économiquefq. Un tour d'horizon auquel se sont livrés le chef de la délégation albanaise et le secrétaire fédéral au commerce extérieur yougoslaves, Emile Ludviger, a permis d'envisager les perspectives futures du commerce albanoyougoslave.“

¹¹⁷ Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë në kuadër të Departamentit të Ekonomisë, 12 prill 1979, në: CH-BAR E7115A 1990-60 313 2.

16. Tetor 1979 për të diskutuar çështjet tregtare midis dy vendeve. Ata gjithashtu me këtë rast nënshkruan protokollin tregtar për vitin 1980. Ky protokoll i shkëmbimit parashikoi „une somme de 80 mio US Dollar“ dhe u konstatua se marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve po vazhdojnë të rriten shumë¹¹⁸ më tutje thuhet, se plani tregtar afatmesëm (1976-80) vlerësonte një tregti mes palëve në shumën prej 172 milionë dollarëve amerikanë, megjithatë, vlerësimet aktuale tejkalojnë 200 milionë dollarë amerikanë, se përparimi është i vazhdueshëm dhe madje rritja ndërmjet viteve 1979 dhe 1980 do jetë rreth 30 e 40%, shkëmbimet janë të balancuara dhe kanë një tendencë për zgjerimin e strukturës, si dhe asortimenteve.¹¹⁹ Kështu projekti hekurudhorë Shkodër-Titograd është quajtur si "facteur de taille de la promotion de la coopération entre les deux pays" (faktor i madh i promovimit të bashkëpunimit midis dy vendeve).¹²⁰ Mandej janë harmonizuan kushtet e marrëveshjes tregtare për periudhën e ardhshme (1981-1985) dhe ishte vlerësuar, se tregtia midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë mund të arrijë vlerën prej \$ 500-600 milion. Ndër të tjera këtu bien në sy se në këtë takim për herë të parë flitet për "kontrata afatgjata" në sektorët e energjisë, minierave dhe transportit, dhe është mundësia e pjesëmarrjes së kompanive jugosllave në ndërtimin e instalimeve dhe punimeve në Shqipëri.¹²¹

Në fund të shkurtit 1980, ambasadori zviceran në Beograd njofton se në mbledhjen e 26 shkurtit 1980 Parlamenti Jugosllav kishte ratifikuar marrëveshjen për ndërtimin e transportit hekurudhor ndërmjet dy vendeve.¹²² Në letrën e legatës zvicerane dt. 25 tetor 1979 ceket se një delegacion shqiptar do të vizitojë Beogradin. Më 10 korrik 1980, Ministri shqiptar për tregtinë e jashtme udhëtoi me një delegacion për një vizitë pesë-ditore në Jugosllavi, ku ata u pritën prej Metod Rotari dhe se ky delegacion do e vizitojë Slloveninë, Maqedoninë dhe Kosovën. Më 17 korrik 1980 përfaqësia zvicerane shkruan, se ai ka kënaqësinë të theksoj se ky shkëmbim i vizitave ministrore shprehë marrëdhëniet e shkëlqyera fqinjësore që po reflektohen "pas 33 vjetësh nga takimi i parë zyrtar i delegacioneve ekonomike shtetërore të Jugosllavisë dhe Shqipërisë" – dhe, thuhet më tutje, të kujtojmë se, në një fjalim në Prishtinë, Presidenti Tito ka komentuar në mënyrë pozitive raportet

¹¹⁸ „Il a été constaté que les relations économiques entre les deux pays se trouvaient en plein essor.“ në: Përfaqësia zvicerane në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë së jashtme, 25 tetor 1979, në: CH-BAR E7115A 1990-60 313 1.

¹¹⁹ Po aty. „Le plan à moyen terme des échanges (1976-80) estimait le montant du commerce entre les deux partenaires à quelque 172 mio US Dollar, or les appréciations actuelles dépassent les 200 mio US Dollar, La progression est constante et même l'augmentation entre les plans de 1979 et de 1980 se situe entre 30 et 40%. Les échanges sont équilibrés et tendent à une expansion de la structure aussi bien que des assortiments“.

¹²⁰ Po aty.

¹²¹ Po aty. „A son retour, le ministre Rotar s'est déclaré satisfait de sa visite et des entretiens qu'il a eu avec son homologue Fedin Hoxha, le vice-président du Conseil ministériel Adil Qiqani, le ministre des transports Luan Babaneta et d'autres personnalités, La presse a tenu à relever la cordialité qui a régné dans les entretiens de la délégation et durant tout son séjour en Albanie et l'ampleur de l'information offerte à ce sujet par la presse albanaise, le ministre Rotar a déclaré en outre dans ce contexte à la presse yougoslave que les deux parties ont constaté "que l'évolution heureuse des relations commerciales entre les deux pays contribuait au progrès des rapports de bon voisinage dans leur ensemble" Cela permettra de plus fréquentes rencontres entre représentants des deux pays; il a d'ailleurs été décidé que le ministre du commerce extérieur Nedin Hoxha se rendrait en Yougoslavie durant l'année 1980.“

¹²² Ambasadori zviceran në Beograd drejtuar sektorit të tregtisë së jashtme, 28 shkurt 1980, në: CH-BAR E7115A 1990-142 269 4.

politike dhe ekonomike.¹²³ Me këtë rast u nënshkruan gjithashtu protokollin e tregtisë për vitin 1982 dhe një marrëveshje tjetër tregtare për vitet 1981-1985. Këto dy marrëveshje u nënshkruan në Beograd më 15 korrik.¹²⁴ Për vitin 1982 u caktua një objektiv tregtar prej 136 miliona dollarë. Gjatë kësaj vizite, shkruan përfaqësimi zviceran, u ra dakord gjithashtu: *“Fixant les modalités d'une rencontre l'an prochain à Tirana, les deux interlocuteurs principaux, Nedin Hoxha et Metod Rotar, ont constaté "que le bon voisinage allié à d'autres avantages d'une saine concurrence technique et technologique était le meilleur garant de la coopération des deux pays" intéressés, l'un et l'autre, à ce que cette coopération soit à long terme, élargie et permette d'améliorer le volume et la structure des échanges.”*¹²⁵

Më 22 tetor 1980 në Beograd nënshkruan një protokoll ministri jugosllav i transportit, Ante Zeliqi, dhe zëvendësministri shqiptar i transportit, Lambi Leku, në të cilin u përcaktua në detaje zhvillimi i linjës hekurudhore Shkodër-Titograd e që në vitet e vijuese përmenden përsëri vetëm si referim në lidhje me vonesat e ndërtimit edhe pse ishte vendosur që kjo vepër të përfundoj në vitin 1983 që gjatë vitit 1982 të mund të përcaktohet data e saktë e inaugurimit të hekurudhës për vitin vijues.¹²⁶ Ambasadori zviceran në Jugosllavi në atë kohë raportonte, se: *„Nënshkrimi i këtij protokoll është një vendim i rëndësishëm politik për Shqipërinë, si pjesë e politikës së saj për t'u larguar nga izolimi i ekonomik. Ministri i tregtisë së jashtme jugosllave Rotar, i cili në fillim të këtij viti vizitoi Tiranën si pjesëtar i parë i qeverisë jugosllave, më tha dje, se ai ishte i befusuar nga pritja miqësore dhe real politike e autoriteteve shqiptare. Dallimet ideologjike u zhvendosën krejt në sfond. Në plan të parë ishte dëshira për të treguar ndjenja miqësore ndaj delegacionit jugosllav. Rotari më konfirmoi se kjo hekurudhë e ardhshme do të ishte shumë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike shqiptare me Jugosllavinë dhe Evropën perëndimore.*

Në këtë kontekst ndoshta ka edhe një ngjarje tjetër, që është hera e parë: ministri i jashtëm Nase bëri një qëndrim në Paris në rrugën e kthimit nga Nju Jorku dhe bisedoi me autoritetet franceze. Pak më vonë zëvendësministri Nushi u prit në Paris për një vizitë zyrtare. Vrhovec thuhet se i ka propozuar ministrit Nase në Nju Jork për të shkëmbyer

¹²³ Përfaqësia zvicerane në Beograd drejtuar zyrës për tregti me jashtë në sektorin e tregtisë, 17 korrik 1980. Lënda: Echanges économiques Yougoslavie/Albanie 1981 - 1985, në : CH-BAR E7115A 1990-142 269 3. *„On s'est plu ici à souligner les excellentes relations de bon voisinage dont cet échange de visites au rang ministériel est le reflet - il s'agit "après 33 ans de la première rencontre officielle de délégations économiques étatiques de Yougoslavie et d'Albanie" - et à rappeler que, dans un discours de 1 an passé à Pristina, le Président Tito avait commenté favorablement ces rapports tant politiques qu'économiques.”*

¹²⁴ Po aty. *„L'accord à moyen terme prévoit un volume d'échanges d'une valeur de 720 mio US, mais la tendance actuelle du commerce entre les deux pays laisse entrevoir la possibilité même de dépasser le milliard de dollars. Comparée aux échanges réalisés durant la période quinquennale actuelle, d'une valeur de 172 mio US\$, la valeur de ceux prévus de 1981 à 1985, représente un "bond de 320\$, ce que les deux délégations ont relevé tout particulièrement. La structure des exportations yougoslaves porte surtout sur du fer à béton, des rails de chemin de fer, des tubes/tuyaux en acier et tôle, du fil de fer, des briques réfractaires, des articles "de la technique électrique", des postes de télévision, des machines et lignes industrielles complètes, certains produits chimiques, techniques, textiles et alimentaires (un éventail demeurant sensiblement toujours le même), L'Albanie fournira, pour sa part, du minerai et des concentrés de chrome, de l'énergie électrique, du bitume, de l'essence et benzine, du gasoil, du cognac, du tabac, des produits du textile, chimiques et autres (la remarque ci-dessus vaut également ici).”*

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Krhs. po ashtu përfaqësia e Zvicrës në Beograd, ambasadori Hess, drejtuar byrosë federale të transportit, sektorit për tregti të jashtëm, 11 shkurt 1981, lënda : Voie ferrée Yougoslavie - Albanie (Titograd - Shkoder), në: CH-BAR E7115A 1991-189 323 1.

gjithashtu vizita midis Tiranës dhe Beogradit në fushën politikës së jashtme. Nase duhet të ketë thënë, se për këtë duhet të pritet ca kohë.”¹²⁷

